



Ndërtesa e Elektrokovës *Elektrokosova Building*
Bulevardi Bill Klinton nr.3 *Bill Clinton Bulevard no.3*
Prishtinë 10000 *Prishtina 10 000*
Republika e Kosovës *Republic of Kosovo*



**Raport mbi kohën mesatare për pranimin e pëlqimit energjetik për
kyçje në rrjetin e shpërndarjes të energjisë elektrike**

Shkurt, 2017



I. Hyrje

Ky dokument është hartuar nga KEDS, dhe shërben si njoftim i përgjithshëm mbi procedurat për kyçje të konsumatorëve në rrjetin e shpërndarjes, dhe kohës mesatare për marrjen e pëlqimit energjetik për kyçje në rrjetin e shpërndarjes të energjisë elektrike.

Kyçja në rrjetin e shpërndarjes të energjisë elektrike është e rregulluar me Metodologjinë e Taksës për Kyçje, e cila ofron procedurat e plota për aplikuesit dhe përdoruesit e sistemit të shpërndarjes të cilët kërkojnë lidhje të reja, apo modifikim të lidhjeve ekzistuese.

Në përgjithësi, janë disa hapa prej momentit kur konsumatori aplikon me kërkesën për kyçje në sistemin e shpërndarjes deri në kohën kur ai kyçet. Megjithatë, për qëllime të këtij raporti, ne do të përqendrohemi vetëm në kohën e nevojshme për të marr një pëlqim energjetik (miratim), duke filluar nga data e aplikimit. Në këtë kuptim:

1. Konsumatori aplikon për pëlqim energjetik në kompaninë për furnizim, në distriktin përkatës.
2. Distrikti përcjell dokumentet në ndërtesën qendrore (NQ), prej nga ato tutje përcillen tek Departamenti për Pëlqime Energjetike dhe Pranim Teknik të Kompanisë së Shpërndarjes (OSSh).
3. Departamenti për Pëlqime Energjetike dhe Pranim Teknik, pas pranimit të aplikacionit, kryen analizat e nevojshme dhe lëshon lejen preliminare për kyçje.

Përderisa, dy hapat e parë përfundojnë brenda 1 dite, analiza e dokumentacionit të pranuar dhe lëshimi i pëlqimit energjetik zgjat më shumë, respektivisht dhënien e pëlqimit energjetik me të gjitha kërkesat relevante teknike që duhet të përmbushen nga konsumatori më pas në mënyrë që të marrë leje për t'u lidhur në rrjetin e shpërndarjes. Mesatarisht në vite pëlqimi energjetik lëshohet brenda 5 ditëve, me një gamë të mundshme të devijimit.

Kapitulli në vijim do të ofroj të gjitha informatat e rëndësishme për vitin 2016.

II. Koha mesatare për pranimin e pëlqimit energjetik në vitin 2016

Cilësia komerciale përcakton efikasitetin dhe saktësinë e zgjidhjes së ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve, dhe merr parasysh marrëdhënien e ndërsjellë në mes të konsumatorëve dhe furnizuesit.

Në standardet e cilësisë komerciale, përveç tjerash, janë edhe lidhjet e reja, me të cilat regjistrohet se sa shpejt ndërmarrja energjetike merr masa për ekzekutimin e lidhjeve të reja.

Tabela e mëposhtme paraqet numrin e kërkesave për lidhje të reja të pranuar në OSSh gjatë vitit 2016, të kategorizuara sipas niveleve të tensionit dhe ditëve mesatare kalendarike të këtij procesi, që nga koha kur konsumatorët bëjnë kërkesën deri në kohën që ai e merr pëlqimin.



Kërkesë për lidhje të re	Niveli I Tensionit të Mesëm	Niveli I Tensionit të Ulët
Numri i kërkesave	830	25,135
Ditët mesatare për pranimin e një pëlqimi	26	20

Shënim: Ditët e paraqitura janë ditë kalendarike, duke përfshirë vikendet

Për qëllim të këtij raporti, ne do të përqendrohemi kryesisht në kërkesën e tensionit të mesëm. Për më tepër, marr parasysh se ditët mesatare për të përfunduar procesin e marrjes së pëlqimit energjetik në sistemet e shpërndarjes varet nga vetë konsumatorët, të dhënat e përpunuara marrin për bazë vetëm rastet kur kërkesa e konsumatorit është e plotë dhe e mbështetur me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

Në vitin 2016 prej 830 kërkesave të pranuar në KEDS, 669 prej tyre janë paraqitur me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, dhe ditët mesatare nga koha e dorëzimit të dokumenteve deri në dhënien e pëlqimit janë 6 ditë pune, siç tregohet në tabelën më poshtë:

Muajt	Nr. i kërkesave për lidhje	Ditët mesatare për pranimin e pëlqimit
Janar	34	5.83
Shkurt	57	6.80
Mars	65	5.09
Prill	55	7.37
Maj	75	6.60
Qershor	46	5.66
Korrik	63	5.00
Gusht	51	5.79
Shtator	63	7.27
Tetor	60	5.83
Nëntor	51	5.82
Dhjetor	49	5.57
Total/Mesatarja	669	6.05

Shënim: Ditët paraqesin vetëm ditët e punës (me përjashtim të vikendeve)

Për sa i përket sektorit të energjisë, Kosova ndahet në 7 distrikte kryesore :

1. Ferizaj
2. Gjakova
3. Gjilan



4. Mitrovica
5. Peja
6. Prishtina, dhe
7. Prizren

Tabela e mëposhtme tregon se Distrikti i Prishtinës i përcjellë nga Distrikti i Ferizajit janë distriktet me numrin më të lartë të kërkesave për kyçje në tensionin e mesëm, ndërsa Distrikti i Gjakovës dhe i Mitrovicës janë ato me numrin më të vogël të kërkesave të pranuar për lidhje. Ndërsa për kohën mesatare të pranimit të pëlqimit Prishtina udhëheq mesatarisht me vetëm 5.35 ditë gjatë vitit 2016.

Muajt	Nr. i kërkesave për lidhje	Ditët mesatare për pranimin e pëlqimit
DFE	133	6.26
DGJ	58	7.65
DGL	63	5.75
DMI	46	5.79
DPE	62	6.05
DPR	214	5.35
DPZ	93	5.53
Total/Mesatarja	669	6.05

III. Shënimet Përfundimtare

Në korrik të vitit 2016 u miratuan Ligjet e reja në sektorin e energjisë. Në këtë kuptim, sektori i energjisë elektrike është në proces të ndryshimit të legjislacionit sekondar dhe terciar, pjesë të të cilave janë të lidhura me procesin e dhënies së lejes për kyçje, si në nivelin e tensionit të ulët ashtu edhe në atë të mesëm. Metodologjia e re e Taksës për Kyçje është duke u hartuar nga OSSh-ja, e cila do të ndikojë pozitivisht në këtë proces dhe procesin e të bërit biznes në përgjithësi.

Publikimi i këtij raporti, i cili synon t'i informoj qytetarët mbi kohën mesatare të nevojshme për të marrë pëlqimin preliminar energjetik për kyçje, si parakusht për vazhdimin e punimeve të ndërtimit, do të bëhet një botim i rregullt vjetor i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.